



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E PARQËVE DHE REKREACIONIT

Datë __. __. 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Karburanti”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Benzinë 09132000-3,

Naftë 09134000-7,

Karburant diesel 09134100-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

33,903,330 (tridhjetë e tre milion e nentëqind e tre mijë e treqind tridhjetë) lekë pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë.

LOTI 1: “Blerje gazoil deri në 10 ppm”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; përkatësisht 2% e vlerë së fondit limit të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...” dhe “...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhë...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/b dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse Autoriteti Kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe Kreut II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, te VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohej deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime” ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në prill të vitit 2026 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2026 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2025 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2023, 2024 dhe 2025.

2.1.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.1.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor ku të përfshihen **këstet e maturuara të vitit 2026** sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i

ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.2 Kapaciteti teknik

2.2.1 Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoritetit kontraktor, Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (dy) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve që duhet të jenë brenda territorit të Bashkisë Tiranë të cilat duhet të sigurojnë furnizim të pandërprerë, 24 orë në çdo ditë të javës në të paktën 1 (një) pikë furnizimi në qytetin e Tiranës. Operatorët Ekonomikë duhet të provojnë se disponojnë stacione të shitjes së karburanteve me pakicë në pronësi dhe/ose me qira, të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB; përmes certifikatës së pronësisë dhe/ose kontratës noteriale të qirasë me afat përgjatë gjithë marrëveshjes kuadër.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listën e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas tabelës së mëposhtme me të dhënat përkatëse:

Tabela nr. 1 orientuese:

Nr	Bashkia Tiranë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Përgjatë Rrugës _____		
2	Përgjatë Rrugës _____		
3	*Etj.....		

*Etj- Nënkupton të gjitha stacionet e shitjes së karburanteve me pakicë të tjera të cilat Operatori Ekonomik i disponon (në pronësi ose me qira).Për të gjitha stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

- Licencë lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë;
- Leje mjedisore e tipit B lëshuar nga QKB;
- Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK)

- Certifikatë e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave;

Theksojmë se nevoja për 2 (dy) pika karburanti, funksionale 24 orë në qytetin e Tiranës, lind nga fakti një flotë prej afërsisht 40 mjeteve të llojeve dhe tonazheve të ndryshme. Rrjedhimisht AK gjykon se kërkesa për 2 (dy) pika karburanti në qytetin e Tiranës, duke qënë se veprimtaria e tij shtrihet në të gjithë qytetin e Tiranës, kjo është një kërkesë minimale, e bazuar në natyrën, llojin dhe vlerën e kontratës. Më tej AK gjykon se kërkesa për 2(dy) pika karburanti është e mirë gjykuar edhe për të bërë ballë situatave të emergjencës, dhe për të kursyer kohë në të tilla raste. Vendosja e këtij kriteri është e rëndësishme për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë e ofertuesit, dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Gjithashtu kërkesa për dokumentacion të noterizuar të qirasë së ambienteve ku do të merret shërbimi, përbën një garanci shtesë për të mos hasur problematika apo mosrealizim të kontratës përgjate afatit që AK do të marrë shërbimin nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është e nevojshme për garantimin e furnizimit me karburant të mjeteve motorike pa pasur nevojë të bëhen shumë kilometra vetëm për tu furnizuar. Kjo kërkesë mbështetet në nenin 40, pika 2.3.5ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet gjithashtu të sigurojë 1 (një) autobot jo më shumë se 1000 litra për arsye të furnizimit sipas nevojave të sektorëve të ndryshëm të Autoritetit Kontraktor. Mjeti duhet të zotëroj Certifikatën e pronësive, leje qarkullimi, taksat vjetore, siguracion, akt kolaudimi, çertifikatën për transport mallrash të rrezikshëm brenda vendit, çertifikatën e inspektimit, pashaport autoboti, i cili të bëjë të mundur furnizimin e autoritetit kontraktor. Keto dokumenta duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë.

Ne rast se është marrë me qera të paraqesë kontratën e qera-marrjes, të shoqëruar me lejen e qarkullimit të qiradhenesit, siguracionin e mjetit, taksat, Certifikatën për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit, pashaportin e botit dhe Certifikatën e kontrollit teknik të mjetit.

Për sa me sipër operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë perkatëse sipas formatit të mëposhtem: Nr. Lloji i mjetit Targa Kapaciteti mbajtës Statusi 1 Pronësi/qira/perdorim 2 Pronësi/qira/perdorim

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtës	Statusi
1				Pronësi/ Qira/Përdorim
2				Pronësi/Qira/ Përdorim

Kërkesa për mundësinë e furnizimit me karburant nëpërmjet autobotëve është përcaktuar mbi bazën e nevojës objektive për garantimin e furnizimit të pandërprerë të mjeteve në vendndodhjet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, si dhe për sigurimin e një menaxhimi sa më efikas të shërbimit. Kjo kërkesë lidhet ngushtë me distancat, specifikat operative dhe nevojat e AK-së për furnizim me karburant. Për këtë arsye, kërkohet disponimi i të paktën 1 (një) autoboti me kapacitet deri në 1000 litra, për të mundësuar furnizimin në terren të mjeteve, veçanërisht të atyre me tonazh të rëndë, të cilat në situata emergjente ose për shkak të kushteve operative e kanë të pamundur paraqitjen pranë pikave të shitjes me pakicë të karburantit. Kapaciteti maksimal prej 1000 litrash është përcaktuar për shkak të kufizimeve të hapësirës dhe terrenit në zonën e aksesit. Kjo masë synon garantimin e vazhdimësisë së shërbimit dhe përmbushjen në kohë të nevojave të institucionit.

Argumentim:

Në bazë, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.2.3 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë pike Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:

a. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. **ose**

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe përcaktimeve të nenit 40, pika 4, paragrafi 1, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021.*

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të

realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.2.4 Operatorët Ekonomikë pjesmarrës në tender duhet të jenë pajisur me çertifikatat, si më poshtë:

a. ISO 14001:2026 mbi “**Sistemet e menaxhimit të mjedisit**” ose ekuivalente të tij me objekt aktiviteti të certifikatës në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, të jenë në gjuhën shqip ose anglisht, të jenë origjinale ose të njehësuara me origjinalin.

b. ISO 9001:2015 mbi “**Sistemet e menaxhimit të cilësisë**” ose ekuivalente të tij me objekt aktiviteti të certifikatës në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ I vlerësimit të konformitetit akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, të jenë në gjuhën shqip ose anglisht, të jenë origjinale ose të njehësuara me origjinalin.

Argumentimi:

Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

ISO 14001 është një standard që i referohet sistemit të menaxhimit të mjedisit.

ISO 14001:2026 përqëndrohet tek identifikimi i atyre aktiviteteve që mund të gjenerojnë aspekte domethënëse në mjedis dhe tek aplikimi i masave kontrolluese. Qëllimi është ulja ose eliminimi i efekteve negative mbi mjedisin të lidhura me aktivitetet e shoqërisë. Aplikimi i ISO 14001 ndihmon shoqërinë të përmirësojë performancën e saj mjedisore nëpërmjet uljes së sasisë të mbetjeve të gjeneruara dhe përdorimin me efikasitet të burimeve natyrore.

ISO 9001:2015 ISO 9001 është standardi më popullor i publikuar në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë të cilat mund të implementohen dhe certifikohen nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensionit të saj apo fushës së aktivitetit. Kërkesat e ISO 9001:2015 i referohen aspekteve të ndryshme siç janë: implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve

dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve. Certifikimi ISO 9001 përfaqëson një konfirmim të faktit që shoqëria respekton një seri kërkesash të pranueshme në nivel ndërkombëtar.

2.2.5 Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike:

a. Fletë analizë ose raport analizë i cilësisë për **Gazoil deri 10 ppm**, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial ISHTI ose laborator të tjere kombëtar ose ndërkombëtar të akredituar jo më larg se 6 muaj nga data e hapjes së tenderit.

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.2.6 Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë përgjatë vitit të fundit.

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve

ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.2.7 Operatori Ekonomik pjesëmarrës me anë të nje deklarate siguron se do të ofrojë mundësinë që shërbimi i furnizimit me karburant të kryhet me kartë elektronike edhe tollona, gjë që mundëson identifikimin e mjetit dhe përdoruesin e tij.

Operatori ekonomik fitues do të furnizojë nëpërmjet tollona me prerje si më poshtë:

Specifikimi i tollonit të Gazoil deri në 10 ppm:

- Lloji i karburantit (Gazoil deri në 10 ppm)
- Sasia e litrave në tollonë 10 litra ose 20 litra
- Muaji/Viti
- Ngjyra e ndryshme sipas llojit
- Nr.i serisë

Kontraktuesi është i detyruar brenda 5 ditëshit të parë të çdo muaji të pajisi me tollonat përkatës (Gazoil deri në 10 pp)

Bazuar në pikën 1, të VKM-së Nr. 561, datë 29.07.2016, “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, ku parashikohet se njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj...”, **Autoriteti Kontraktor në funksion të realizimit pa ndërprerje të shërbimit dhe duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë të mjeteve të ndryshme, rastet e emergjencës, zonat e operimit dhe nevojën për furnizim të vazhdueshëm me karburant, kërkon që operatori ekonomik të ofrojë dhe mundësinë e furnizimit me tollona karburanti në raste të veçanta operationale të autorizuar nga AK. Disa mjete pune, si motokorrëset dhe pajisje të tjera të ngjashme, kërkojnë furnizim me karburant në terren, gjë që nuk mund të realizohet në mënyrë efektive përmes përdorimit të kartave elektronike të karburantit.**

Argumentim:

Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standardeve dhe direktivave si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Kjo kërkesë bazohet në parimet e proporcionalitetit, efektivitetit dhe përdorimit me eficiencë të fondeve publike, të parashikuara në Ligjin nr.

162/2020 'Për Prokurimin Publik', si dhe në nevojën për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit publik në çdo situatë operationale.

Shënim: Operatorët Ekonomik të cilët do të paraqesin ofertat për më shumë se një lot, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta, xhiron vjetore te tre viteve te fundit dhe përvojën e ngjashme te cituara si mësipër, si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

2.3 Specifikime teknike

2.3.1 Gazoil deri në 10 ppm duhet të jetë në përputhje me standardin **SSH EN 590:2025**, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Argumentimi:

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Specifikimet teknike për artikujt e kërkuar Blerje gazoil, përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

Nr.	Treguesit	Njësia matjes	Kufijtë	
			Minimum	Maksimum
1	Numri i cetanit		51.0	
2	Indeksi i cetanit		46.0	
3	Densiteti në 15 °C	Kg/m ³	820,0	845,0
4	Hidrokarburet aromatik policiklike	% m/m	-	8,0
5	Përmbajtja e squfurit	mg/kg		10,0
6	Pika e flakërimit	°C	55	-
7	Mbetja e karbonit (në 10 % mbetje distilimi)	% m/m	-	0,30

8	Përmbajtja e hirit	% m/m	-	0,010
9	Pika e bllokimit të filtrit në të ftohtë CFPP	⁰ C		
10	Korrozioni në shufër bakri (3 orë në 50 ⁰ C)	vlerësim	Klasa 1	
11	Përmbajtja e esterit metilik të acidit yndyror (FAME)	% v/v	-	7,0
12	Viskoziteti në 40 ⁰ C	mm ² /s	2,00	4,50
13	Përmbajtja e ujit	%m/m		0.020
14	Lubriciteti, diametri i korrektuar i gërvishtjes (ësd 1,4) në 60 ⁰ C	µm	-	460
15	Pika e turbullimit	⁰ C	-	-
16	Ndotja e përgjithshme	mg/kg	-	24
17	Stabiliteti ndaj oksidimit	g/m ³	-	25
18	Distilimi :			
	Distilati që vlon deri në 250 ⁰ C, % (v/v)	% v/v	-	< 65
	Distilati që vlon deri në 350 ⁰ C, % (v/v)	% v/v	85	
	95 % (v/v) distilon në	⁰ C		360

LOTI 2: Blerje benzinë pa plumb

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,
Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; përkatësisht 2% e vlerë së fondit limit të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.
Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...” dhe “...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhë...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/b dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqenëse Autoriteti Kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqenëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe Kreut II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, te VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohej deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime” ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në prill të vitit 2026 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2026 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2025 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2023, 2024 dhe 2025.

2.1.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.1.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor ku të përfshihen **këstet e maturuara të vitit 2026** sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i

ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.1 Kapaciteti Teknik

2.2.1 Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoritetit kontraktor, Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (dy) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve që duhet të jenë brenda territorit të Bashkisë Tiranë të cilat duhet të sigurojnë furnizim të panderprerë, 24 orë në çdo ditë të javës në të paktën 1 (një) pikë furnizimi në qytetin e Tiranës. Operatorët Ekonomikë duhet të provojnë se disponojnë stacione të shitjes së karburanteve me pakicë në pronësi dhe/ose me qira, të pasqyruara në në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB; përmes certifikatës së pronësisë dhe/ose kontratës noteriale të qirasë me afat përgjatë gjithë marrëveshjes kuadër.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listën e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas tabelës së mëposhtme me të dhënat përkatëse:

Tabela nr. 1 orientuese:

Nr	Bashkia Tiranë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Përgjatë Rrugës ____		
2	Përgjatë Rrugës ____		
3	*Etj.....		

*Etj- Nënkupton të gjitha stacionet e shitjes së karburanteve me pakicë të tjera të cilat Operatori Ekonomik i disponon (në pronësi ose me qira).Për të gjitha stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

- Licencë lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë;
- Leje mjedisore e tipit B lëshuar nga QKB;
- Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK)
- Certifikatë e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave;

Theksojmë se nevoja për 2 (dy) pika karburanti, funksionale 24 orë në qytetin e Tiranës, lind nga fakti një flotë prej afërsisht 40 mjeteve të llojeve dhe tonazheve të ndryshme. Rrjedhimisht AK gjykon se kërkesa për 2 (dy) pika karburanti në qytetin e Tiranës, duke qënë se veprimtaria e tij shtrihet në të gjithë qytetin e Tiranës, kjo është një kërkesë minimale, e bazuar në natyrën, llojin dhe vlerën e kontratës. Më tej AK gjykon se kërkesa për 2(dy) pika karburanti është e mirë gjykuar edhe për ti bërë ballë situatave të emergjencës, dhe për të kursyer kohë në të tilla raste. Vendosija e këtij kriteri është e rëndësishme për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë e ofertuesit, dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Gjithashtu kërkesa për dokumentacion të noterizuar të qirasë së ambienteve ku do të merret shërbimi, përbën një garanci shtesë për të mos hasur problematika apo mosrealizim të kontratës përgjate afatit që AK do të marrë shërbimin nga operatori ekonomik.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është e nevojshme për garantimin e furnizimit me karburant të mjeteve motorike pa pasur nevojë të bëhen shumë kilometra vetëm për tu furnizuar. Kjo kërkesë mbështetet në nenin 40, pika 2.3.5ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.*

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet gjithashtu të sigurojë 1 (një) autobot jo më shumë se 1000 litra për arsye të furnizimit sipas nevojave të sektorëve të ndryshëm të Autoritetit Kontraktor. Mjeti duhet të disponojë Certifikatën e pronësise, leje qarkullimi, taksat vjetore, siguracion, akt kolaudimi, çertifikatën për transport mallrash të rrezikshëm brenda vendit, çertifikatën e inspektimit, pashaport autoboti, i cili të bëjë të mundur furnizimin e autoritetit kontraktor. Keto dokumenta duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë.

Ne rast se është marrë me qera të paraqese kontratën e qera-marrjes, të shoqëruar me lejen e qarkullimit të qiradhenesit, siguracionin e mjetit, taksat, Certifikatën për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit, pashaportin e botit dhe Certifikatën e kontrollit teknik të mjetit.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqesë nje deklarate sipas formatit te meposhtem: Nr. Lloji i mjetit Targa Kapaciteti mbajtes Statusi

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronësi/ Qira/ Përdorim
2				Pronësi/ Qira/ Përdorim

Kërkesa për mundësinë e furnizimit me karburant nëpërmjet autobotëve është përcaktuar mbi bazën e nevojës objektive për garantimin e furnizimit të pandërprerë të mjeteve në vendndodhjet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, si dhe për sigurimin e një menaxhimi sa më efikas të shërbimit. Kjo kërkesë lidhet ngushtë me distancat, specifikat operative dhe nevojat e AK-së për furnizim me karburant. Për këtë arsye, kërkohet disponimi i të paktën 1 (një) autoboti me kapacitet deri në 1000 litra, për të mundësuar furnizimin në terren të mjeteve, veçanërisht të atyre me tonazh të rëndë, të cilat në situata emergjente ose për shkak të kushteve operative e kanë të pamundur paraqitjen pranë pikave të shitjes me pakicë të karburantit. Kapaciteti maksimal prej 1000 litrash është përcaktuar për shkak të kufizimeve të hapësirës dhe terrenit në zonën e aksesit. Kjo masë synon garantimin e vazhdimësisë së shërbimit dhe përmbushjen në kohë të nevojave të institucionit.

Argumentim:

Në bazë, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.2.3 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjate 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere jo me pak se 40% të vlerës së përlloragitur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë pike Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:

a. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara. **ose**

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit

në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe përcaktimeve të nenit 40, pika 4, paragrafi 1, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021.*

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.2.4 Operatorët Ekonomik pjesmarrës në tender duhet të jenë pajisur me çertifikatë, si më poshtë:

- a. ISO 14001:2026** mbi “**Sistemet e menaxhimit të mjedisit**” ose ekuivalente të tij me objekt aktiviteti të certifikatës në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, të jenë në gjuhën shqip ose anglisht, të jenë origjinale ose të njuhësuar me origjinalin.
- b. ISO 9001:2015** mbi “**Sistemet e menaxhimit të cilësisë**” ose ekuivalente të tij me objekt aktiviteti të certifikatës në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ I vlerësimit të konformitetit akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, të jenë në gjuhën shqip ose anglisht, të jenë origjinale ose të njuhësuar me origjinalin.

Argumentimi:

Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

ISO 14001 është një standard që i referohet sistemit të menaxhimit të mjedisit. ISO 14001:2026 përqëndrohet tek identifikimi i atyre aktiviteteve që mund të gjenerojnë aspekte domethënëse në mjedis dhe tek aplikimi i masave kontrolluese. Qëllimi është ulja ose eliminimi i efekteve negative mbi mjedisin të lidhura me aktivitetet e shoqërisë. Aplikimi i ISO 14001 ndihmon shoqërinë të përmirësojë performancën e saj mjedisore nëpërmjet uljes së sasisë të mbetjeve të gjeneruara dhe përdorimin me efikasitet të burimeve natyrore.

ISO 9001:2015 ISO 9001 është standardi më popullor i publikuar në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë të cilat mund të implementohen dhe certifikohen nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensionit të saj apo fushës së aktivitetit. Kërkesat e ISO 9001:2015 i referohen aspekteve të ndryshme siç janë: implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve. Certifikimi ISO 9001 përfaqëson një konfirmim të faktit që shoqëria respekton një seri kërkesash të pranueshme në nivel ndërkombëtar.

2.2.5 Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike:

a. Fletë analizë ose raport analizë i cilësisë për **Benzinë pa plumb**, lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial ISHTI ose laborator të tjere kombëtar ose ndërkombëtar të akredituar jo më larg se 6 muaj nga data e hapjes së tenderit.

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.2.6 Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të leshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë përgjatë vitit të fundit.

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.2.7 Operatori Ekonomik pjesëmarres me anë të nje deklaratë siguron se do të ofrojë mundësinë që shërbimi i furnizimit me karburant të kryhet me kartë elektronike edhe tollona, gjë që mundëson identifikimin e mjetit dhe përdoruesin e tij.

Operatori ekonomik fitues do ti furnizoje nëpërmjet tollona me prerje si më poshtë:

- Specifikimi i tollonit të **benzinë pa plumb**:
- Lloji i karburantit (**benzinë pa plumb**)
- Sasia e litrave në tollonë 10 litra ose 20 litra
- Muaji/Viti
- Ngjyra e ndryshme sipas llojit
- Nr.i serisë

Kontraktuesi është i detyruar brenda 5 ditëshit të parë të çdo muaji të pajisi me tollonat përkatës (**Benzinë pa plumb**)

Bazuar në pikën 1, të VKM-së Nr. 561, datë 29.07.2016, “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, ku parashikohet se njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj...”, **Autoriteti Kontraktor në funksion të realizimit pa ndërprerje të shërbimit**

dhe duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë të mjeteve të ndryshme, rastet e emergjencës, zonat e operimit dhe nevojën për furnizim të vazhdueshëm me karburant, kërkon që operatori ekonomik të ofrojë dhe mundësinë e furnizimit me tollona karburanti në raste të veçanta operationale të autorizuara nga AK. Disa mjete pune, si motokorrëset dhe pajisje të tjera të ngjashme, kërkojnë furnizim me karburant në terren, gjë që nuk mund të realizohet në mënyrë efektive përmes përdorimit të kartave elektronike të karburantit.

Argumentim:

Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standardeve dhe direktivave si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Kjo kërkesë bazohet në parimet e proporcionalitetit, efektivitetit dhe përdorimit me eficiencë të fondeve publike, të parashikuara në Ligjin nr. 162/2020 'Për Prokurimin Publik', si dhe në nevojën për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit publik në çdo situatë operationale.

Shënim: *Operatorët Ekonomik të cilët do të paraqesin ofertat për më shumë se një lot, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta, xhiron vjetore të tre viteve të fundit dhe përvojën e ngjashme të cituara si mësipër, si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

2.2 Specifikime teknike

2.3.1 Benzina pa plumb duhet të jetë në përputhje me standartin **SSH EN 228:2025**, sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Specifikimet teknike për artikujt e kërkuar Benzina pa plumb, përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (neni 40 pika 2).

Nr	Treguesit	Njësia matjes	Kufijtë	
			Minimum	Maksimum
1	Numri i oktanit kërkimor NOK		95	
2	Numri i oktanit motorrik NOM		85	
3	Densiteti në 15 °C	kg/m ³	720,0	775,0
4	Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10,0
5	Korozioni i shufrës së bakrit (3 orë / 50 °C)	Renditje	Klasa 1	
6	Pamja e jashtme		E pastër dhe e tejdukshme	
7	Destilimi			
A	Distilon deri 70 °C	% v/v	20	48
B	Distilon deri 100 °C	% v/v	46,0	71,0
C	Distilon deri 150 °C	% v/v	75	-
D	Pika finale e distilimit	°C	-	210
E	Mbetjet e distilimit	% v/v	-	2
8	Përmbajtja e tipit të hidrokarburit			
A	Olefinat	% v/v	-	18,0
B	Aromatikët	% v/v	-	35,0
9	Përmbajtja e benzenit	% v/v	-	1,0

10	Përmbajtja e oksigjenit	%(m/m)	-	2,7	
11	Përmbajtja e komponimeve oksigjenore				
A	Methanol (alkool metilik)	% v/v	-	3	
B	Etanol (alkool etilik)			5	
C	Alkool terc - butil				Përzierja në vëllim i kufizuar në 2.7 % (m/m) të përmbajtjes
	Komponime oksigjenore të tjera				
	Etere (me 5 ose më shumë atome C)				
				maksimale të oksigjenit	

LOTI 3: “ Blerje gaz (LPG)”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; përkatësisht 2% e vlerë së fondit limit të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...” dhe “...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhë...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/b dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse Autoriteti Kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe Kreut II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, te VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohej deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime” ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në prill të vitit 2026 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2026 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2025 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2023, 2024 dhe 2025.

2.1.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.1.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor ku të përfshihen **këstet e maturuara të vitit 2026** sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i

ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore , do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.2 Kapaciteti teknik

2.2.1 Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoritetit kontraktor, Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (dy) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve që duhet të jenë brenda territorit të Bashkisë Tiranë të cilat duhet të sigurojnë furnizim të pandërprerë, 24 orë në çdo ditë të javës në të paktën 1 (një) pikë furnizimi në qytetin e Tiranës. Operatorët Ekonomikë duhet të provojnë se disponojnë stacione të shitjes së karburanteve me pakicë në pronësi dhe/ose me qira, të pasqyruara në ekstraktin e regjistrit tregtar lëshuar nga QKB; përmes certifikatës së pronësisë dhe/ose kontratës noteriale të qirasë me afat përgjatë gjithë marrëveshjes kuadër.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listën e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas tabelës së mëposhtme me të dhënat përkatëse:

Tabela nr. 1 orientuese:

Nr	Bashkia Tiranë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Përgjatë Rrugës _____		
2	Përgjatë Rrugës _____		
4	*Etj.....		

*Etj- Nënkupton të gjitha stacionet e shitjes së karburanteve me pakicë të tjera të cilat

Operatori Ekonomik i disponon (në pronësi ose me qira).Për të gjitha stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

- Licencë lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë;

- Leje mjedisore e tipit B lëshuar nga QKB;
- Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK)
- Certifikatë e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave;

Theksojmë se nevoja për 2 (dy) pika karburanti, funksionale 24 orë në qytetin e Tiranës, lind nga fakti një flotë prej afërsisht 40 mjetesh të llojeve dhe tonazheve të ndryshme. Rrjedhimisht AK gjykon se kërkesa për 2 (dy) pika karburanti në qytetin e Tiranës, duke qënë se veprimtaria e tij shtrihet në të gjithë qytetin e Tiranës, kjo është një kërkesë minimale, e bazuar në natyrën, llojin dhe vlerën e kontratës. Më tej AK gjykon se kërkesa për 2(dy) pika karburanti është e mirë gjykuar edhe për ti bërë ballë situatave të emergjencës, dhe për të kursyer kohë në të tilla raste. Vendosja e këtij kriteri është e rëndësishme për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë e ofertuesit, dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Gjithashtu kërkesa për dokumentacion të noterizuar të qirasë së ambienteve ku do të merret shërbimi, përbën një garanci shtesë për të mos hasur problematika apo mosrealizim të kontratës përgjate afatit që AK do të do të marrë shërbimin nga operatori ekonomik.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është e nevojshme për garantimin e furnizimit me karburant të mjeteve motorike pa pasur nevojë të bëhen shumë kilometra vetëm për tu furnizuar. Kjo kërkesë mbështetet në nenin 40, pika 2.3.5ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.*

2.2.2 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:

a. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. **ose**

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe përcaktimeve të nenit 40, pika 4, paragrafi 1, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.2.3 Operatorët Ekonomik pjesmarrës në tender duhet të jenë pajisur me çertifikatë, si më poshtë:

a. ISO 14001:2026 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente të tij me objekt aktiviteti të certifikatës në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, të jenë në gjuhën shqip ose anglisht, të jenë origjinale ose të njehësura me origjinalin.

b. ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente të tij me objekt aktiviteti të certifikatës në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ I vlerësimit të konformitetit akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, të jenë në gjuhën shqip ose anglisht, të jenë origjinale ose të njehësura me origjinalin.

Argumentimi:

Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

ISO 14001 është një standard që i referohet sistemit të menaxhimit të mjedisit.

ISO 14001:2026 përqëndrohet tek identifikimi i atyre aktiviteteve që mund të gjenerojnë aspekte domethënëse në mjedis dhe tek aplikimi i masave kontrolluese. Qëllimi është ulja ose eliminimi i efekteve negative mbi mjedisin të lidhura me aktivitetet e shoqërisë.

Aplikimi i ISO 14001 ndihmon shoqërinë të përmirësojë performancën e saj mjedisore

nëpërmjet uljes së sasisë të mbetjeve të gjeneruara dhe përdorimin me efikasitet të burimeve natyrore.

ISO 9001:2015 ISO 9001 është standardi më popullor i publikuar në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë të cilat mund të implementohen dhe certifikohen nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensionit të saj apo fushës së aktivitetit. Kërkesat e ISO 9001:2015 i referohen aspekteve të ndryshme siç janë: implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve. Certifikimi ISO 9001 përfaqëson një konfirmim të faktit që shoqëria respekton një seri kërkesash të pranueshme në nivel ndërkombëtar.

2.2.4 Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike:

- a. Fletë analizë ose raport analizë i cilësisë për **Gaz (LPG)**, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial ISHTI ose laborator të tjere kombëtar ose ndërkombëtar të akredituar jo më larg se 6 muaj nga data e hapjes së tenderit..

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.2.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë përgjatë vitit të fundit.

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.2.6 Operatori Ekonomik pjesëmarres me anë të nje deklarate siguron se do të ofroj mundësinë që shërbimi i furnizimit me karburant të kryhet me kartë elektronike, gjë që mundëson identifikimin e mjetit dhe përdoruesin e saj.

***Argumentim:** Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standardeve dhe direktivave si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.*

***Shënim:** Operatorët Ekonomik të cilët do të paraqesin ofertat për më shumë se një lot, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta, xhiron vjetore të tre viteve të fundit dhe përvojën e ngjashme të cituara si mësipër, si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.*

2.3 Specifikime teknike

2.3.1 Gazi (LPG) duhet të jetë në përputhje me standartin SSH EN 589:2024

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Për çdo standard ose emërtim marke të përmendur pranohet dhe ekuivalenti i tyre.

Argumentim: Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Specifikimet teknike për artikujt e kërkuar GAZ (LPG), përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Sasitë e karburantit paraprakisht të përlogaritura që kërkohen, gjatë afatit të zbatimit të kontratës, për plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor në përputhje me fondin e miratuar në buxhetin e vitit 2026 nga Bashkia Tiranë, janë si më poshtë:

LOTI 1: Blerje gazoil deri në 10 ppm

14,373 litra/muaj x 12muaj = 172,476 litra

LOTI 2: Blerje benzinë pa plumb

3634litra/muaj x 12muaj = 43,608 litra

LOTI 3: Blerje Gaz (LPG)

848 litra/muaj x 12muaj = 10,176 litra

Nga sa mësipër fondi limit i përlogaritur për procedurën “Blerje karburanti” është:

LOTI 1: Blerje gazoil deri në 10 ppm

Fondi limit 26,906,690 (njëzet e gjashtë milion e nëntëqind e gjashtë mijë e gjashtë qind e nëntëdhjetë)

LOTI 2: Blerje benzinë pa plumb

Fondi limit 6,426,640 (gjashtë milion e katërqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzet)

LOTI 3: Blerje Gaz (LPG)

Fondi limit i përafërt: 570,000 lekë (pesëqind e shtatëdhjetë mijë)

Fondi limit total i procedurës: 33,903,330 lekë pa tvsh

Shënim: Sasitë e shënuara më sipër, janë të përafërta, llogaritur për një periudhë 12 mujore (per vitin buxhetor 2026). Sasitë e mësipërme janë përlogaritur duke respektuar aktet nënligjore për përlogaritjen e çmimit, por ato mund të ndryshojnë sipas kërkesave mujore në rritje apo në ulje, në varësi të ndryshimit të çmimit të karburanteve bazuar në konjunkturën e bursave ndërkombëtare dhe tregut vendas dhe nevojave faktike të konsumit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të mos e tërheqin të gjithë sasinë e karburantit, në rast se nuk i nevojitet për proceset e tyre të punës.

Operatori Ekonomik fitues bazuar në “Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.561 datë 29/07/2016 Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” dhe në njoftimin nr.2123 datë 31.01.2017 të APP, në përfundim të procedurave të prokurimit do të marrë një listë të mjeteve efektive të transportit apo pajisjeve të punës, me qëllim

pajisjen e tyre me kartë elektronike të personalizuar. Shërbimi i furnizimit me karburant pranë pikës së karburantit për mjetet e transportit do të kryhet nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohet identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i tij.

Për mjetet e tjera jashtë kriterëve të VKM nr.564 datë 29.07.2016 "*Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*" operatori ekonomik fitues do të furnizojë nëpërmjet tollona me prerje si më poshtë:

Specifikimi i tollonit të Gazoil deri në 10 ppm dhe Benzinës pa plumb:

- a. Lloji i karburantit (Gazoil deri në 10 ppm dhe Benzinës pa plumb)
- b. Sasia e litrave në tollonë 10 litra ose 20 litra
- c. Muaji
- d. Viti
- e. Ngjyra e ndryshme sipas llojit
- f. Nr.i serisë
- g. Kontraktuesi është i detyruar brenda 5 ditëshit të parë të çdo muaji të pajisi me tollonat përkatës (Benzinë e Gazoil deri në 10 pp)

Furnizimi me Gazoil deri në 10 ppm dhe/ose Benzinë pa plumb 10 ppm do të bëhet sipas nevojave dhe kërkesave faktike të Autoriteteve Kontraktore, brenda 3 (tre) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, sipas sasisë që përcakton kërkesa, me kartë ose tollon, sipas nevojave.

Bazuar në pikën 1, të VKM-së Nr. 561, datë 29.07.2016, "*Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, ku parashikohet se njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj...", Autoriteti Kontraktor në funksion të realizimit pa ndërprerje të shërbimit dhe duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë të mjeteve të tonazhit të rëndë, rastet e emergjencës, zonat e operimit dhe nevojën për furnizim të vazhdueshëm me karburant, kërkon që operatori ekonomik të ofrojë dhe mundësinë e furnizimit me tollona karburanti në raste të veçanta operationale të autorizuara nga AK.

Në çmimin dhe vlerën e ofertës, përfshihen të gjitha kostot operative dhe korrente, kostot e kartave elektronike, tollona apo transportit, risqet dhe përgjegjësitë ndaj të tretëve, detyrimet për pagimin e çdo detyrimi tatimor apo doganor Përfshirë këtu edhe detyrimin për pagimin e akcizës, taksës së qarkullimit, skanimit dhe çdo detyrim tjetër ligjor në fuqi në datën e lidhjes së kontratës apo detyrime të tjera që shtohen gjatë zbatimit të kontratës, sipas legjislacionit në fuqi.

Afatet e lëvrimit:

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Lëvrimi i mallit do të fillojë menjëherë pas lidhjes së kontratës dhe do të kryhet në mënyrë periodike, sipas kërkesave dhe nevojave faktike të Autoritetit Kontraktor, sipas kushteve të parashikuara në dokumentet e tenderit.

Ofertuesi duhet të sigurojë furnizim të pandërprerë, 24 orë në çdo ditë të javës në të pakten 1 (një) pikë furnizimi në qytetin e Tiranës.

Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, **vlera absolute e normës së fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës**, në rast të luhatjes së çmimeve.

Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë Autoriteti Kontraktor duhet të bëj likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.

Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shtijes së mallit, objekt kontrate, Autoritetit Kontraktor, si dhe cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë të cilën është shpallur fitues kontraktori. *(pikat 9 dhe 10 të nenit 107 të V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar).*

Shënim: Në të gjitha rastet kur është përmendur emri ose markë, njihet barazvleshmëria ose ekuivalent.